



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE

KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 63 Prot

Tiranë, më 31.07. 2007

VENDIM Nr. 13 dt. 27.07.2007

Për miratimin e kërkesave për pajisjen me licensë restaurimi

Në mbështetje të ligjit nr. 9592, datë 27.07.2006, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9048, dt 07.04.2003 "Për Trashëgiminë Kulturore", neni 17, si dhe bazuar në vendimin nr. 8, dt. 16.10.2006 të KKR, për miratimin e rregullores "Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e kërkesave të paraqitura për pajisjen me licensë restaurimi profesionale personale të kategorisë a) Projektim dhe zbatim në restaurimin e monumenteve të arkitekturës

c) Restaurim i veprave të artit dhe objekteve muzale.

konstatoi se:

1. Në testim u paraqitën dokumente nga personat fizikë të mëposhtëm:

- Z. Mustafa Arapi
- Z. Albert Plumbi
- Prof. Dr. Pirro Thomo

2. Pas shqyrtimit të dokumentacionit rezultoi se:
plotësojnë kriteret personat fizikë të mëposhtëm:

- Z. Mustafa Arapi
- Z. Albert Plumbi
- Prof. Dr. Pirro Thomo

Për këtë arsye Këshilli Kombëtar i Restaurimeve

VENDOSI:

- Të pajisë me licensë restaurimi të kategorisë (a),

- Prof. Dr. Pirro Thomo

- dhe të kategorisë (c),

- Z. Mustafa Arapi
- Z. Albert Plumbi

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

PROF. DR. YLLI PANGO

KRYETAR

SEKRETAR I K.K.R.

LORENC BEJKO